



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përputhje me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.3 dhe nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Neni 4 paragrafi 2 dhe 3, neni 5 dhe 6 dhe Rregullore Nr. 12/2022 Për Procedurën e Zgjedhjes, Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, si dhe Vendimit KGJK Nr. 502/2022 të datës 27 Dhjetor 2022 shpall:

KONKURS PËR KRYETAR TË GJYKATËS SUPREME

1. Gjykata e Supreme – Kryetar i Gjykatës;

KRITERET

1. Për kandidatin për Kryetar të Gjykatës dhe Gjyqtar Mbikëqyrës mund të aplikoj vetëm gjyqtari që vjen nga radhët e gjykatës përkatëse, duke përfshirë edhe degët e saj.

2. Kandidati për Kryetar të Gjykatës, respektivisht Gjyqtar Mbikëqyrës duhet të plotësoj kriteret themelore si në vijim:

- 2.1. të jetë gjyqtar me mandatë të përhershëm;
- 2.2. të mos ketë sanksion disiplinor me vendim të formës së prerë, përjashtimisht masën vërejtje jo publike me shkrim;
- 2.3. të mos ketë aktakuzë të konfirmuar për ndonjë vepër penale, përveç veprave penale të kryera nga pakujdesia;
- 2.4. të mos jetë i dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë, përveç veprave penale të kryera nga pakujdesia;
- 2.5. të ketë së paku shkallë vlerësimi të performancës “shumë mirë”.

Kandidatët të cilët nuk kanë të drejtë aplikimi

1. Të drejtë për aplikim për pozitën Kryetar Gjykatë apo Gjyqtar Mbikëqyrës nuk kanë:

- 1.1. Anëtari i Këshillit, gjatë ushtrimit të mandatit të tij si dhe pas përfundimit të mandatit brenda periudhës kohore të përcaktuar me legjislacionin në fuqi;
- 1.2. Kryetari i Gjykatës përkatëse i cili ka përfunduar mandatin e tij si Kryetar i asaj Gjykatë, për pozitën si Kryetar Gjykatë;
- 1.3. Gjyqtari Mbikëqyrës i cili ka përfunduar mandatin e tij si Gjyqtar Mbikëqyrës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për pozitën si Gjyqtar Mbikëqyrës në Dhomën e Posaçme, si dhe Gjyqtari mbikëqyrës në Degë të Gjykatës Themelore për pozitën Gjyqtar mbikëqyrës në Degë.

Kriteret Vlerësuese

1. Kandidati për Kryetar të Gjykatës/Gjyqtar Mbikëqyrës përveç profesionalizmit dhe kualifikimeve për kryerjen e funksionit, duhet të ketë aftësi dhe njohuri në kryerjen e punëve të udhëheqjes dhe organizimit brenda gjykatës/degës sipas kriterëve në vijim:

- 1.1. njohjen e punëve të administratës gjyqësore;
- 1.2. të qenit kreativ në punë duke lehtësuar punën e gjykatës/degës,
- 1.3. komunikimin korrekt me palë dhe kolegë brenda gjykatës/degës;
- 1.4. gatishmërinë për bashkëpunim me organizata dhe institucione tjera.

2. Vlerësimi i kriterëve nga paragrafi 1 i këtij neni të kandidatit për Kryetar Gjykatë/Gjyqtar Mbikëqyrës bëhet përmes intervistës me gojë.

3. Përveç kriterëve vlerësues të parapara me paragrafin 1 të këtij neni Komisioni vlerësues do të vlerësoj edhe koncept dokumentin me shkrim të dorëzuar nga kandidati me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse dhe do të marrë në konsideratë trajnimet e specializuara, përvojën menaxheriale, vlerësimin e performancës dhe reputacionin të cilin kandidati gëzon nga ana e kolegëve gjyqtarë.

4. Koncepti dokumenti tregon vizionin e kandidatit për mënyrën e menaxhimit të gjykatës/degës si dhe ngritjes së efikasitetit në bazë të resurseve ekzistuese, i cili duhet të përmbajë:

- 4.1. vizionin në lidhje me rregullat dhe strategjitë që duhet implementuar në gjykatë/degë gjatë mandatit të tij;
- 4.2. vizionin për menaxhimin e gjykatës/degës duke përfshirë planin për reduktimin e lëndëve të mbetura dhe masa të tjera për rritjen e efikasitetit të gjykatës/degës.

5. Koncepti Dokumenti sipas paragrafit 4 të këtij neni, duhet të ketë jo më pak se tre (3) dhe jo më shumë se shtatë (7) faqe.

FORMULARI I APLIKIMIT

- formularin mund ta shkarkojnë në Ueb faqen e KGJK-së. (www.gjyqesori-rks.org)

[Shkarko Aplikacionin](#)

AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Data e fillimit të aplikimi: 29 Dhjetor 2022

Data e fundit të aplikimit: 12 Janar 2022

Formularët për aplikim dorëzohen, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit në:

Sekretariatit e KGJK-së, Rruga ‘Luan Haradinaj’ nr. 133, Prishtinë në Zyrën e Pranimit.

RREGULLAT DHE PROCEDURAT

Kandidatëve që aplikojnë për pozitën përkatëse do t`ju kërkohen dokumente të ndryshme për të mbështetur aplikacionin e tyre. Lidhur me këtë çështje, secili kandidat do të kontaktohet individualisht dhe përmes e-mail adresave për t`ju dërguar formularët dhe detajet për procedurat e mëtejshme.